



Profeti ﷺ merrte abdes për çdo namaz

Amër ibn Amiri tregon se Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Profeti ﷺ merrte abdes për çdo namaz. E pyeta: "Po ju, si vepronit?" Tha: "Mjaftoheshim me një abdes, përderisa nuk e prishnim atë."

[Ky hadith është sahih] [E shënon Buhariu]

Profeti ﷺ merrte abdes për çdo namaz farz, edhe nëse abdesi nuk i prishej. Kjo, për të marrë shpërblim dhe mirësi. Namazliut i lejohet të falë më shumë se një namaz farz me një abdes, përderisa vazhdon të ketë abdes.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65080>

